

EC
MA NDRYSHË

URAT E GJAKOVËS DHE TË PEJËS

MONUMENTET QË LIDHIN HISTORINË ME TË ARDHMEN



URAT E GJAKOVËS DHE TË PEJËS MONUMENTET QË LIDHIN HISTORINË ME TË ARDHMEN

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 049 714 024

Hulumtimi "Urat e Gjakovës dhe të Pejës: Monumentet që lidhin historinë me të ardhmen" është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni" përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përbajtja dhe qëndrimet e paraqitura në këtë hulumtim nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorit.



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	04
Historiku i ndërtimit të Urave dhe rëndësia e tyre.....	06
Urat e Gjakovës.....	07
Ura e Terzive.....	08
Ura e Tabakëve.....	10
Ura e Fshajtë (Ura e Shenjtë).....	12
Ura Romake.....	14
Ura e Talqit.....	15
Ura e Islam Begut.....	16
Urat e reja të ndërtuara në Gjakovë.....	17
Urat e Pejës.....	19
Ura e Gurit.....	20
Ura e Gurit me Hark në Grykën e Rugovës.....	21
Ura e Kilometrit të 10-të.....	22
Ura e Rexhep Agës.....	23
Ura e Zallit.....	24
Ura e Gegajve.....	25
Ura e Miletbahçes.....	26
Urat e humbura të Pejës.....	27
Ura e vjetër pranë Patrikanës së Pejës.....	27
Ura e vjetër te Sharra.....	27
Ura Turistike atraktive në Gjakovë dhe Pejë.....	28
Ura tibetiane në Grykën e Rugovës.....	28
Ura tibetiane në Gjakovë.....	29
Përfundime dhe Rekomandime.....	30
Përfundime.....	30
Rekomandime.....	31
Foto të vjetra të urave në Gjakovë dhe Pejë.....	32
Koordinatat e urave.....	33
Tabela: Urat e Gjakovës dhe të Pejës.....	35
Vendndodhja e urave të rajonit të Gjakovës.....	36
Vendndodhja e urave të rajonit të Pejës.....	37
Burimet.....	38
Për EC-in.....	40

HYRJE

Urat përbëjnë elemente të rëndësishme të trashëgimisë kulturore e inxhinierike në Kosovë, duke shërbyer jo vetëm si infrastrukturë funksionale për kalimin e lumenjve, por edhe si dëshmi të zhvillimeve historike, ekonomike dhe shoqërore të vendit.

Në zonat e Gjakovës dhe të Pejës, ato kanë një dimension të veçantë për shkak të pozicionit gjeografik, të pasurisë hidrografike dhe të rrjeteve të hershme tregtare që kanë lidhur këto qytete me rajonin më të gjërë të Ballkanit.

Në këtë pjesë të Kosovës, urat kanë pasur një rol vendimtar në zhvillimin urban, ekonomik dhe kulturor. Të vendosura në një hapësirë ku lumenjtë e shumtë si Drini i Bardhë, Ereniku, Krena dhe Lumbardhi i Pejës kanë formësuar jetën shoqërore dhe ekonomike, këto struktura kanë qenë të domosdoshme për komunikim, tregti dhe lëvizje, por njëkohësisht janë shndërruar edhe në simbole të identitetit dhe trashëgimisë lokale. Më vonë, me ardhjen e materialeve të reja si betoni e çeliku, ura të tjera moderne e kanë plotësuar këtë trashëgimi, duke i zgjeruar mundësitë për qarkullim, turizëm dhe shfrytëzim ekonomik.

Në Gjakovë, urat kanë qenë pjesë integrale e lidhjes së qytetit me fshatrat përreth dhe me rrugët tregtare që kalonin në drejtim të Shkodrës, Prizrenit dhe më tej në viset e Adriatikut. Ura e Terzive, e ndërtuar në shekullin XVIII mbi lumin Erenik, është një shembull i shkëlqyer i arkitekturës së kohës në Kosovë, e cila jo vetëm siguroi qarkullimin

e mallrave dhe njerëzve, por mbeti e lidhur ngushtë me esnafin e terzive që kontribuan për ndërtimin e saj. Po ashtu, Ura e Fshejtë, e ngritur mbi kanionin e Drinit të Bardhë, është jo vetëm një strukturë funksionale, por edhe një monument që sot shërben si atraksion turistik dhe pikë takimi i traditës me aventurën moderne.

Në Pejë, urat përgjatë Lumbardhit kanë qenë pjesë organike e jetës urbane që nga mesjeta. Ato shërbyen për të lidhur qytetin me zonat e ndryshme, me pazarin karakteristik dhe me fshatrat përreth Rugovës. Arkitektura e tyre është karakterizuar nga harqe të ulëta prej guri, të ndërtuara me mjeshtëri me gurë, duke krijuar struktura që harmonizohen natyrshëm me mjedisin. Në Grykën e Rugovës, përvëç urave të gurit që lidhin segmentet malore, në periudhën moderne janë ndërtuar edhe ura të varura dhe struktura të lehta për turizëm dhe sporte ekstreme, të cilat pasqyrojnë zhvillimin e funksioneve të reja të urave në këtë rajon.

Hulumtimi i urave në këto dy qytete ofron një tablo të gjërë mbi mënyrën se si komunitetet lokale kanë ndërvepruar me natyrën dhe si e kanë shfrytëzuar mjeshtërinë ndërtimore për të siguruar qarkullim e zhvillim. Në aspektin historik, urat nuk janë vetëm struktura inxhinierike, por edhe monumente që bartin në vete kujtesën e brezave, tregojnë për organizimin e komunitetit, për ndikimet e pushtimeve dhe për rrugët e tregtisë që kanë kaluar përmes këtyre trevave.




Megjithatë, përveç rëndësisë së tyre historike e kulturore, urat e Gjakovës dhe Pejës sot përballen me sfida të shumta. Faktorë si erozioni i shtratit lumor, përmbytjet sezonale, ndërhyrjet jo profesionale, ndërtimet e pakontrolluara pranë brigjeve dhe përdorimi i tyre për trafik më të rëndë sesa janë parashikuar, rrezikojnë autenticitetin dhe qëndrueshmërinë e këtyre monumenteve. Për më tepër, mungesa e planeve gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe promovimin e tyre shpesh e lë këtë trashëgimi të çmuar në marginat e kujdesit institucional.

Duke i parë urat si pjesë të pandashme të historisë dhe të së tashmes, ky hulumtim synon të kontribuojë në dokumentimin, interpretimin dhe vlerësimin e tyre, por njëkohësisht edhe të ndikojë në ndërgjegjësim për nevojën e ruajtjes së kësaj trashëgimie për

gjeneratat e ardhshme. Në një kohë kur turizmi kulturor dhe ai natyror po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi në Kosovë, urat e Gjakovës dhe Pejës mund të luajnë një rol kyç si ura që lidhin jo vetëm brigje, por edhe të shkuarën me të ardhmen, traditën me zhvillimin modern dhe komunitetet mes vete.

Ky hulumtim, duke u mbështetur në dokumente arkivore, literaturë ekzistuese dhe vëzhgime në terren është një përpjekje për të kuptuar një pjesë të rëndësishme të identitetit lokal dhe kombëtar, për të nxjerrë në pah sfidat që rrezikojnë këtë pasuri dhe për të propozuar qasje që sigurojnë mbrojtjen dhe promovimin e tyre. Përmes kësaj, do të synohet që urat e Gjakovës dhe Pejës të mos mbeten thjesht monumente të së kaluarës, por të shndërrohen në ura të gjalla që mbajnë gjallë historinë, kulturën dhe shpresën për një zhvillim të qëndrueshëm.



HISTORIKU I NDËRTIMIT TË URAVE DHE RËNDËSIA E TYRE

Hulumtimi paraprak i EC Ma Ndryshe, për urat e Prizrenit ka të dhëna sa i përket zhvillimit historik të ndërtimit të urave në përgjithësi. Duke qenë se ky hulumtim vjen si vazhdim i atij raporti, në këtë pjesë janë rikapituluar informatat e rëndësishme lidhur me historikun e ndërtimit të urave dhe rëndësisë së tyre.

Urat janë ndër strukturat më të hershme inxhinierike të ndërtuara nga njerezimi, që datojnë që nga kohët e hershme. Me kalimin e shekujve, ato kanë evoluar nga struktura të thjeshta për kalimin e pengesave natyrore, në vepra madhështore të arkitekturës dhe inxhinierisë moderne.

Historiku i ndërtimit të urave reflekton zhvillimin e shoqërive, teknologjive dhe nevojave të njerëzve. Këto ura u ndërtuan për të plotësuar nevojat bazike të kalimit, por shpesh nuk i rezistonin forcave të natyrës për shkak të materialeve të brishta që përdoreshin. Megjithatë, me kalimin e kohës, zhvillimi i teknikave dhe i materialeve të reja e transformoi ndërtimin e urave.

Në Mesopotami dhe Egjiptin e lashë, urat e ndërtuara prej tullave dhe gëlqeres u përdorën për të lidhur vendbanimet dhe për të lehtësuar tregtinë. Urat mbi Eufratin dhe Nilin ishin shembuj të hershëm të teknologjisë së përparuar në ndërtim.

Por me zhvillimin e qytetërimit romak, teknologjia e ndërtimit të urave arriti një nivel të ri. Romakët përdorën harjet dhe betonin e hershëm, që ishin rezistent ndaj ujit, për të ndërtuar ura që mund të mbijetonin për mijëvjeçarë. Ura e Alcántara në Spanjë dhe Ponte Sant'Angelo në Romë janë shembuj të inxhinierisë romake që ende admirohen sot për qëndrueshmërinë dhe bukurinë e tyre.

Në Mesjetë, ndërtimi i urave u përqendrua në strukturat prej guri. Urat gjatë periudhës

mesjetare dhe Rilindjes u bënë më të sofistikuara dhe shpesh përfshinin elemente arkitektonike të bukura, si statuja dhe dekorë të detajuara. Ura Charles në Pragë është një shembull i shkëlqyer i kësaj periudhe, e cila bashkonte funksionalitetin me estetikën. Kjo urë, e ndërtuar në shekullin e XIV, ishte një simbol i fuqisë dhe qëndrueshmërisë së qytetit. Në Evropë, urat mesjetare u bënë pikë kyçe për zhvillimin e tregtisë.

Gjatë periudhës osmane, ndërtimi i urave mori një zhvillim të madh, duke përfshirë teknika më të avancuara dhe përdorimin e gurëve dhe llaçit. Në Prizren, dallohet Ura e Gurit, e cila është ndërtuar në shekullin e XVI dhe që prej atëherë përbën një pikë kyçe të qytetit, duke lidhur brigjet dhe duke lehtësuar qarkullimin e njerëzve. Kjo urë, me harqet e saj të forta dhe dizajnin e qëndrueshëm, shërbente jo vetëm për kalim, por edhe si një pikë takimi për tregtarët dhe qytetarët, duke mbledhur elemente të qëndrueshme të peizazhit urban dhe të jetës së përditshme.

Sot është njëra prej pikë takimeve kryesore të turistëve, ku edhe realizohen fotografitë për kujtim nga qyteti i vjetër. Me zhvillimin e teknologjisë, ka filluar edhe përdorimi i çelikut dhe hekurit në ndërtimin e urave, si pjesë e rëndësishme e zhvillimit urban dhe ndërlidhjes së qyteteve të mëdha, duke shërbyer si urë lidhëse për tregti dhe transport.

Historiku i ndërtimit të urave është një tregim i zhvillimit teknologjik dhe shoqëror të njerëzimit. Nga strukturat e thjeshta prej druri e guri, deri te veprat inxhinierike bashkëkohore, urat kanë shërbyer si simbole të lidhjes, përparimit dhe bashkëpunimit. Ato vazhdojnë të janë dëshmi e aftësisë njerëzore për të kapërcyer kufijtë natyrore dhe për të ndërtuar lidhje të qëndrueshme midis vendeve dhe njerëzve.

URAT E GJAKOVËS

Gjakova njihet si qytet me disa ura që gjelqinë mbrojtje ligjore, meqë përfaqësojnë një thesar të çmuar të trashëgimisë kulturore dhe historike në Kosovë.

Aktualisht, pesë ura brenda kësaj komune janë të përfshira në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkozhshme. Këto ura, të shpërndara në pjesë të ndryshme të qytetit dhe rrithinës, nuk janë vetëm struktura ndërtimore për kalim, por edhe dëshmi të periudhave të ndryshme historike dhe kulturave që kanë kaluar mbi këtë hapësirë.

Meqenëse Gjakova ka qenë ndër qendrat më të rëndësishme tregtare e zejtare në rajon, urat kanë luajtur një rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin urban, ekonomik dhe shoqëror të qytetit. Ato shërbyen si pika kyçe komunikimi ndërmjet lagjeve, qyteteve dhe trevave përreth, duke ndikuar drejtpërdrejt në jetën e përditshme të banorëve dhe në formësimin e identitetit të qytetit.

Arkitektura e urave të Gjakovës përfaqëson mjeshterinë e ndërtuesve vendorë dhe

ndikimin e stileve të ndryshme ndërtimore, kryesisht osmane, të cilat kombinojnë funksionalitetin me estetikën. Shumica prej tyre janë ndërtuar me gurë lokalë, duke respektuar terrenin dhe karakteristikat natyrore të lumenjve mbi të cilët shtrihen. Përveç funksionit utilitar, urat kanë qenë shpesh të lidhura me esnafët e qytetit, të cilët jo vetëm që kanë financuar ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre, por edhe i kanë dhënë emra që ruhen ende sot.

Në këtë kapitull, do të trajtohen urat më të njohura të Gjakovës – si Ura e Terzive, Ura e Tabakëve, Ura e Fshajtë, Ura Romake, Ura e Taliqit dhe Ura e Islam Begut – duke u ndalur te rëndësia e tyre historike, arkitekturore dhe kulturore. Po ashtu, do të pasqyrohet edhe gjendja e tyre aktuale dhe roli që luajnë urat moderne në jetën e përditshme të qytetit. Përmes këtij rrëfimi, synohet të kuptohet më mirë jo vetëm vlera arkitektonike e këtyre urave, por edhe kontributi i tyre në trashëgiminë kolektive të Gjakovës dhe të Kosovës në tërësi.

Urat më të njohura dhe të rëndësishme të Gjakovës janë:

- * Ura e Terzive
- * Ura e Tabakëve
- * Ura e Fshajtë (Ura e Shenjtë)
- * Ura Romake
- * Ura e Taliqit
- * Ura e Islam Begut
- * Ura tibetiane në Gjakovë



URA E TERZIVE

Ura e Terzive mbi lumin Erenik është një nga monumentet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Sipas të dhënave zyrtare të prezantuara në Databazën e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, kjo urë që gjendet në fshatin Bishtazhin të Gjakovës, është ndërtuar në shekullin XVIII nga Esnafi i Terzive në Gjakovë.

Ura ka pasur rëndësi të madhe ekonomike sepse ka mundësuar lidhjen e rrugëve tregtare në mes të vilajeteve brenda Perandorisë Osmane.

Rëndësia e urës nuk qëndron vetëm në funksionin e saj. Bazuar në vlerësimet e profesionistëve ajo mishëron vlera të shumta historike, sociale, kulturore dhe arkitektonike.

Gjatë periudhës osmane ka luajtur një rol të rëndësishëm në lidhjen e tregtisë ndërmjet vilajeteve dhe rajoneve përreth, duke kontribuar në mirëqenien ekonomike të komuniteteve lokale.

Për vlerat e saj të larta, nga viti 1962 gjëzon mbrojtje ligjore.



E ndërtuar me gurë lokalë të latuar, ura përbëhet nga njëmbëdhjetë harqe gjysmë-rrethore dhe dhjetë dritareve shkarkuese (qemer) ndërmjet tyre. Ajo është rreth 193 metra e gjatë dhe afersisht 5 metra e gjerë, duke pasur një kapacitet të konsiderueshëm për qarkullimin e njerëzve dhe transportit me kafshë. Struktura dhe ritmi vizual i harqeve e bëjnë atë një shembull të përkryer të arkitekturës osmane në Ballkan, ku bukuria dhe funksioni shkojnë paralelisht.

Ajo ka kaluar në disa fazë restaurimi. Ndërhyrjet kanë ndodhur në vitet 1982-1984 nga Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë. Në vitin 2015, organizata CHwB ka ndërhyrë në pjesët më të dëmtuara të urës në kuadër të një programi për mbrojtjen emergjente të trashëgimisë. Intervenimet kanë pasuar edhe në vitin 2019, me restaurimin e gurëve, ndriçimin, ndërtimin e promenadave, ndjenjëset dhe gjelbërimin e zonës përreth, duke e kthyer urën në një hapësirë publike funksionale.

Sot, ura është e dedikuar për këmbësorë dhe vizitorë, dhe ndonëse gjendja e saj është përgjithësisht e mirë, nevojitet mirëmbajtje e rregullt për të garantuar mbijetesën e saj për brezat që vijnë.



Përveç rëndësisë së saj shumëdimensionale, ura bart edhe elemente simbolike dhe kulturore që e bëjnë edhe më të veçantë. Në gurët e saj janë të gdhendura vizatime dhe mbishkrime të kohës, detaje këto që ngjallin kureshtje dhe nxisin interpretime për ndikimet e ndryshme kulturore që kanë kaluar mbi këtë vend. Një mbishkrim dëshmon se ndërtimi i urës së parë ishte porosi e Esnafit të Terzive, dhe për këtë arsyе në popull ura është njohur si "Ura e Terzive".



Burimet:

Ura e Terzive - Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:

<https://dtk.rks.gov.net/Objekti?Heritageld=2861>

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjakovë

Ura e Terzive - Atlas Obscura:

<https://www.atlasobscura.com/places/ura-e-terzive>

Ura e Terzive në Gjakovë, një arritje e jashtëzakonshme arkitektonike – Telegrafi:

<https://telegrafi.com/ura-e-terzive-ne-gjakove-nje-arritje-e-jashtezakonshme-arkitektonike/>

Mbylljet faza emergjente në urën më emblematike të Gjakovës - CHWB Kosova:

https://chwbkosova.org/sq/chwb_news/mbylljet-faza-emergjente-ne-uren-me-emblematike-te-gjakoves-2/

URA E TABAKËVE



E ndërtuar mbi lumin Erenik, në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës, Ura e Tabakëve është njëra prej veprave të dalluara të trashëgimisë kulturore në qytet. Ndërtimi i saj i atribuohet esnafit të tabakëve, zejtarëve që përpunonin lëkurën, të cilët ishin pjesë e veçuar e ekonomisë së qytetit. Sipas disa burimeve, ura është ndërtuar në shekullin XVIII.

Funksioni i saj ka qenë thelbësor për lidhjen e Gjakovës me qytete si Shkodra, Kukësi dhe Bajram Curri, duke shërbyer si një pikë kyçe për qarkullimin e mallrave dhe njerëzve. Kjo e vendosi urën në qendër të rrjeteve tregtare që shtriheshin përtëj kufijve të sotëm, në një kohë kur Gjakova kishte lulëzuar si qendër zejtare dhe tregtare.

Ura ka një gjatësi prej 127 metrash dhe një gjerësi prej rreth 4 metrash. Ajo përbëhet nga shtatë harqe gjysmë-rrethore dhe dritare shkarkuese, të ndërtuara me gurë të latuar, tipar i zakonshëm i urave të periudhës osmane.

Struktura është një shembull i qartë i mjeshtërisë ndërtimore të kohës, që kombinon funksionalitetin me estetikën tradicionale. Në gurët e ballinave ruhen ende ornamente të gdhendura me simbole që besohet se i përkasin mjeshtërve ndërtues si forma veglash, rozeta dekorative dhe peizazhe simbolike. Motivet e gdhendura ofrojnë një vështrim të rrallë në botëkuptimin estetik dhe artin popullor të mjeshtërve që kontribuan në ndërtimin e saj.

Këto elemente e bëjnë urën të veçantë, jo vetëm si infrastrukturë por edhe si një dëshmi kulturore e kohës.

Për rëndësinë e saj historike dhe arkitekturore, ura është përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje. Ajo vlerësohet si një nga urat më të mëdha të ndërtuara në territoret shqiptare gjatë mesjetës dhe vazhdon të jetë pjesë e identitetit kolektiv të qytetit.

Në vitin 2004, ura iu nënshtua një restaurimi të plotë, duke u përshtatur vetëm pér këmbësorë pér tē ruajtur strukturën nga dëmtimi. Në vitin 2019, zona pérreth u përmirësua me shtigje guri, ndriçim dhe mobilie urbane.



Burimet:

Ura e Tabakëve - Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=2810>

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë

Përurohet Ura e restauruar e Tabakëve në Gjakovë - Koha: <https://www.koha.net/kulture/perurohet-ura-e-restauruar-e-tabakeve-ne-gjakove>

Ura e Tabakëve, Gjakovë - Facebook Monuments of Albania:
<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=2750131531894586&id=1531035643804187&set=a.1531541350420283>

URA E FSHAJTË (URA E SHENJTË)

Ura e Fshajtë, e njohur edhe si "Ura e Shenjtë", është një nga urat më të veçanta në Kosovë, jo vetëm për shkak të ndërtimit të saj mbi Grykën madhështore të Drinit të Bardhë, por edhe për historinë e saj të pasur dhe të mbështjellë me legjenda. E vendosur në rrugën Gjakovë-Prizren, kjo urë ka shërbyer për dekada si pikë lidhëse strategjike dhe njëkohësisht si simbol shpirtëror për komunitetin përreth.

Origjina e saj, sipas të dhënave zyrtare lidhet me shekullin XVII, megjithëse disa burime përmendin se ura në formën e saj aktuale mund të jetë ndërtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ura origjinale u shkatërrua gjatë Luftës së Parë Botërore dhe më pas u rindërtua nga forcat italiane në vitin 1942. Ajo pëson dëme të konsiderueshme edhe gjatë Luftës së Kosovës (1998-1999), por u restaurua sërisht nga KFOR-i italian, duke e ruajtur formën dhe funksionin e saj.

Ura është ndërtuar me gurë të latuar dhe ka një hark të vetëm gjysmë-rrethor, që shtrihet mbi 70 metra gjatësi dhe qëndron mbi 20 metra mbi nivelin e ujit. E gjerë rreth 7 metra, ajo ofron një pamje të rrallë, ku natyra dhe mjeshteria njerëzore ndërthuren në një mënyrë të jashtëzakonshme. Vendndodhja e saj mbi një kanion të thollë të krijuar nga rrjedha e Drinit përmes shkëmbinjve gëlqerorë i jep një karakter unik dhe e kthen në një prej vendeve më të fotografuara dhe të vizituara të Kosovës.

**Ajo që e dallon Urën e Fshajtë nga të tjerat është shtresa e legjendave që e shoqëron. Sipas gojëdhënavëve, për ndërtimin e saj është dashur një sakrificë njerëzore respektivisht një grua e re është sakrifikuar në themel.*

Burimet:

Ura e fshejtë, një histori e veçantë - ATV - Gusht 18, 2023
(Intervista: <https://www.youtube.com/watch?v=9RQJWUYD0>)

Ura e Fshejtë - Lista e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:
https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5360_2_2.pdf

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjakovë
Skënderbeu në gur – Prizrenpress: <https://prizrenpress.com/skenderbeu-ne-gur/>
Ura e Fshajt - legjenda për urën e besës dhe fjalës së dhënë - Epoka e re:
<https://www.epokaere.com/ura-e-fshajt-legjenda-per-uren-e-beses-dhe-fjales-se-dhene/>

e urës për ta mbajtur atë të qëndrueshme. Ky tregim ka ngashmëri me legjenden e Rozafës në Shkodër dhe përforcon motivin e përbashkët kulturor të "flijimit për qëndrueshmëri", që haset në shumë pjesë të Ballkanit.*

Përveç rëndësisë kulturore dhe historike, ura është e mbrojtur si monument i trashëgimisë natyrore dhe kulturore që nga viti 1986. Ajo është bërë pjesë e identitetit lokal dhe një pikë e dashur për vizitorët. Gjatë verës, shndërrohet në destinacion për pushime, me brigjet përreth të mbushura me kampistë dhe familje që shijojnë freskinë e lumit dhe hijen e shkëmbinjve.



URA E FSHAJTË (URA E SHENJTË)

Ura është gjithashtu qendra e një tradite të veçantë, garës vjetore të kërcimeve. Kjo ngjarje, që filloi në vitin 1954 dhe rifilloi pas luftës në vitin 2014, mbledh kërcyes të guximshëm nga e gjithë Kosova dhe rajoni, të cilët hidhen nga ura në ujërat e Drinit, duke e kthyer këtë vend në një arenë të gjallë sporti dhe spektakli.

Në afërsi të urës ndodhen edhe dy formacione shkëmbore me rëndësi simbolike: Shkëmbi i Shqiponjës dhe Shkëmbi i Skënderbeut. Ky i fundit mban një gdhendje të figurës së heroit kombëtar shqiptar, e realizuar në vitin 1968 për ndër të 500-vjetorit të vdekjes së tij, një tjetër dëshmi e lidhjes së këtij vendi me identitetin historik dhe kombëtar shqiptar.



Përkundër dëmtimeve të shumta që ka pësuar ndër vite, Ura e Fshajtë ka ruajtur hijeshinë dhe rolin e saj, falë ndërhyrjeve për restaurim dhe mirëmbajtje. Sot ajo nuk është vetëm një urë për kalim, por një pikë takimi e historisë, natyrës dhe kulturës së gjallë të vendit.



Burimet:

Ura e fshejtë, një histori e veçantë – ATV - Gusht 18, 2023

(Intervista: <https://www.youtube.com/watch?v=i9tRQJWUYD0>)

Ura e Fshajtë - Lista e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:

https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5360_2_2.pdf

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjakovë

Skënderbeu në gur – Prizrenpress: <https://prizrenpress.com/skenderbeu-ne-gur/>

Ura e Fshajt – Legjenda për urën e besës dhe fjalës së dhënë – Epoka e re:

<https://www.epokaere.com/ura-e-fshajt-legjenda-per-uren-e-beses-dhe-fjales-se-dhene/>

MBETJET E NJË URE ROMAKE NË ROGOVË

Në fshatin Rogovë të Gjakovës, në zonën e quajtur Sacranica, janë zbuluar gjurmët e një ure të vjetër që besohet të ketë origjinë antike. Ajo njihet nga banorët si "ura romake", për shkak të teknikës së ndërtimit dhe vendndodhjes strategjike pranë një rruge të vjetër që mund të ketë ndjekur rrjedhën e lumit.

Nga ura janë ruajtur tri fragmente: dy në anën e djathtë të lumit dhe një bazament në anën e majtë.

Ndërtimi i saj është bërë me gurë të mëdhenj dhe mesatarë, të lidhur me llaç gëlqereje të qëndrueshëm. Në strukturë vërehen rreshta të alternuar gurësh dhe rrasash, një teknikë që ngjan me stilin romak opus mixtum, por e përshtatur me materiale lokale.

Dëshmi të tjera, si vrimat për trarët prej druri dhe trashësia e murit që arrin rreth 1.80 metra tregojnë se ura ka qenë ndërtuar me kujdes dhe për qëllime të qëndrueshme. Zona përreth ruan edhe toponime me origjinë latine dhe gjurmë vendbanimesh të vjetra, duke përforcuar idenë se ura ka qenë pjesë e një rrjeti më të gjerë komunikimi në antikitet.

Deri më sot, kjo konsiderohet si ura më e vjetër e evidentuar në rajonin e Gjakovës dhe një nga strukturat më të hershme që dëshmon për ndërtimin monumental përgjatë Drinit të Bardhë. Edhe pse janë ruajtur vetëm pjesë të saj, ajo mbetet një dëshmi e rëndësishme e trashëgimisë së lashtë në këtë pjesë të Kosovës dhe meriton më shumë vëmendje në studime dhe mbrojtje.



Sipas ish-drejtorit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Osman Gojani, ura e gurit në Rogovë është ndërtuar në kohën e perandorëve Justiniani dhe Hadriani, përkatësisht në shekullin I dhe në fillim të shekullit II. Ai thekson se ura ka pasur një gjatësi prej rrëth 8 metrash dhe gjatësi prej afërsisht 70 metrash, ndërsa lartësia ka ndryshuar varësisht nga thellësia e ujit. Një veçori unike e kësaj ure janë të ashtuquajturit "stopa", elemente karakteristike të konstruksionit që përfaqësojnë stilin e ndërtimit të urave të asaj kohe. Ai thekson se ura e gurit është një ndër objektet më të vjetra në këtë rajon dhe se nuk ka ura të tjera të këtij lloji të evidentuara deri më sot në Kosovë.

Në afërsi të urës gjendet edhe Kalaja e Gexhës, e cila ka shtatë kulla dhe struktura të tjera mbrojtëse. Kjo kala, së bashku me urën dhe zonën përreth, përbën një kompleks të pasur arkeologjik. Sipas të dhënave, në këtë zonë janë realizuar të paktën katër gërmime arkeologjike, që dëshmojnë për potencialin e jashtëzakonshëm të trashëgimisë së fshehur në këtë pjesë të komunës së Gjakovës.

Burimet:

HARTA ARKEOLOGJIKE E KOSOVËS - AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË 2006

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore

Ura romake e shekullit I, në Rogovë të Hasit - Klan Kosova interviste me Osman Gojani:

<https://klankosova.tv/ura-romake-e-shekullit-i-ne-rogoeve-te-hasit-video/>

URA E TALIQIT

Në pjesën jugore të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, në rrjedhën e lumit Krena, ndodhet njëra prej urave karakteristike të qytetit, Ura e Taliqit. Kjo urë, e ngritur sipas mbishkrimit në vitin 1816, mban gjurmë të rëndësishme të trashëgimisë osmane dhe shfaq ndikimin që esnafi i tabakëve ka pasur në zhvillimin urban të Gjakovës.

Konstruksioni i saj i ndërtuar me gurë të ghħendur përfshin një hark qendror madhor dhe dy më të vegjel anësorë, të shoqeruar me dritare shkarkuese pér rrjedhën e ujit në raste përmbytjesh. Fillimisht ura kishte një simetri më të qartë dhe një pjesë të mbuluar me konstruksion druri, e cila më vonë u zëvendësua me gur. Sot, ajo ka një gjatësi prej rreth 26 metrash dhe gjerësi mbi 4 metra, dhe ka shërbyer kryesisht pér kalimtarët dhe transport të lehtë me kafshë.

Ura e Taliqit mbetet një element i rëndësishëm në kujtesën kolektive të qytetit, si simbol i lidhjes së dy pjesëve të Gjakovës, por edhe si dëshmi arkitektonike dhe kulturore e periudhës osmane. Në shumë momente të historisë, përfshirë edhe luftën e fundit, ajo është përmendur në rrëfimet e dhimbjes dhe rezistencës së banorëve të qytetit.



Burimet:

Ura e Taliqit - Databaza e Trashëgiminës Kulturore të Kosovës:

<https://dtk.rks.gov.net/Objekti?heritageId=2858>

Qendra Rajonale për Trashëgiminë Kulturore - Gjakovë

Ura e Taliqit ndervitë - Gjakova Sot: <https://www.facebook.com/Gjksot/posts/ura-e-taliqit-ndervitegjakove/2049171681880155/>

Taliq Bridge- Explore Gjakova:

<https://www.explorejakova.com/listing/taliqbridge/>

Artan Krasniqi - Monument Vëllimi III - Shekujt e mesëm (Prishtinë Mitrovicë, Pejë dhe Gjakovë)



Esnafi i tabakëve, i cili qëndron pas ndërtimit të saj, ka lënë gjurmë edhe përtej Gjakovës siç dëshmohet me urën e ngjashme në Tiranë, të ndërtuar në shekullin XVII pér të kapërcyer pérroin e Lanës, një strukturë po ashtu guri, me kalldrëm dhe dy harqe.

Historiani Fejaz Drançolli, në veprën e tij mbi trashëgiminë monumentale në Kosovë, përmend këto ura si pjesë e rëndësishme e arkitekturës osmane në shekujt XV-XIX, duke nënvisuar se shpesh ato kanë mbetur në hije përkundër vlerës së tyre ekonomike, strategjike dhe kulturore. Ai shton se disa prej këtyre urave janë ndërtuar mbi themelet e strukturave shumë më të vjetra, ndoshta që nga antikiteti, çka e shton edhe më shumë rëndësinë e tyre në trashëgiminë shqiptare.



URA E ISLAM BEGUT

Ura e Islam Begut ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën urbane të Gjakovës, duke shërbyer si lidhje ndërmjet Çarshisë së Madhe dhe pjesës qendrore të qytetit. Ajo ishte pjesë e pandarë e rrjetit të komunikimit dhe tregtisë që karakterizonte këtë pjesë të qytetit, duke ndihmuar në lëvizjen e mallrave dhe njerëzve, e rrjedhimisht në zhvillimin ekonomik dhe social të Gjakovës.

Mendohet se ura e parë në këtë vend është ndërtuar në shekullin XVII, ndoshta paralelisht me urën e Taliqit, në periudhën kur Çarshia e Madhe po merrte formën e saj arkitektonike dhe tregtare. Ura e vjetër ishte ndërtuar në stilin osman, me gurë dhe llaç gëlqeror, dhe kishte 4 gjysmëharqe dhe dy dritare shkarkuese që i jepnin asaj pamje monumentale dhe funksionalitet të lartë.



Burimet:
Interview with Visar Haxhibeqirin (director of Qendrës Rjonale për Trashëgimi Kulturore)
Islam Begu Bridge - Wikipedia:
https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Islam_Begu_Bridge.JPG

Fatkeqësishët, ura e vjetër është rrënuar dhe nuk kanë mbetur gjurmë të saj. Sot, në të njëjtin vend gjendet një urë e re e ndërtuar me beton të armuar, e cila ka vetëm dy harqe. Megjithëse ka humbur pamjen dhe strukturën e vjetër, kjo urë vazhdon të mbajë të njëtin funksion lidhës si dikur, duke u shërbyer si rrugë kalimi për këmbësorët dhe mjetet motorike.

Edhe pse nuk ka më gjurmë fizike nga ura osmane, kujtesa e saj jeton përmes emrit dhe rëndësisë që ende mban në jetën e përditshme të qytetit.



URAT E REJA TË NDËRTUARA NË GJAKOVË

Përveç urave historike që dëshmojnë për trashëgiminë arkitektonike dhe kulturore të Gjakovës, qyteti sot mbështetet edhe në një rrjet urash të reja, të ndërtuara për të përballuar nevojat e rritjes urbane dhe komunikimit bashkëkohor. Këto ura moderne, ndonëse kryesisht funksionale dhe të ndërtuara me struktura betoni dhe materiale të qëndrueshme, luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të qytetarëve.

Urat e reja zakonisht janë të projektuara për t'i përshtatur qarkullimit të automjeteve, si dhe për të përmirësuar qarkullimin ndërmjet pjesëve të ndryshme të qytetit, sidomos mbi lumin Krena, i cili kalon nëpër zemër të Gjakovës. Një pjesë e tyre janë ura të ndërtuara pas luftës së fundit, ndërsa të tjera janë ndërtuar për të zëvendësuar urat e vjetra që ishin rrënuar ose nuk përbushnin më standartet e nevojshme të sigurisë dhe transportit.


Përveç urave prej betoni, në disa segmente të qytetit janë ndërtuar edhe ura me konstruksion metalik dhe bazamente prej druri, të cilat shërbejnë kryesisht për kalimin e këmbësorëve. Këto ura ofrojnë lidhje më të shpejta për banorët në zona të caktuara dhe shpesh janë më të lehta për ndërtim e mirëmbajtje. Ato krijojnë një alternativë më të butë në krahasim me masivitetin e strukturave të betonit, duke pasur një prani më të lehtë në peizazhin urban.





Megjithatë, ndërtimi i urave të reja shpesh ka ndodhur pa ndonjë përkushtim estetik ose integrim me peizazhin urban dhe historik të qytetit. Në disa raste, ndërrimi i urave të vjetra me struktura moderne ka sjellë edhe humbje të elementeve të trashëgimisë, siç është rasti i urës së Islam Begut. Kjo ka ngritur diskutime për balancën ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së identitetit kulturor të Gjakovës.

Pavarësisht kësaj, urat e reja janë një pjesë jetike e infrastrukturës urbane, që ndihmojnë në lehtësimin e jetës qytetare dhe në funksionimin efikas të qytetit. Ato shërbejnë si nyje lidhëse ndërmjet lagjeve, tregjeve dhe institucioneve, duke qenë një reflektim i nevojave bashkëkohore të një qyteti në zhvillim.



URAT E PEJËS

Peja, një nga qytetet e rëndësishme të Dukagjinit, ka një histori të gjatë të ndërtimit të urave, të cilat kanë luajtur rol kyç në zhvillimin urban, tregtar dhe kulturor të saj. Edhe pse shumica e urave që shohim sot janë ndërtuar gjatë shekullit XX, ato ruajnë kujtesën e urave shumë më të hershme që dikur e përshkonin qytetin dhe zonat përreth.

Para rrënimit të tyre, këto ura përfaqësonin një pjesë të rëndësishme të jetës së përditshme të banorëve, duke siguruar lidhje me trevat përreth dhe duke shërbyer si nyje strategjike të komunikimit dhe tregtisë.

Në mesin e tyre, Ura e Gurit në Grykën e Rugovës është e vjetmja që ka mbijetuar si

dëshmi e qartë e traditës së vjetër ndërtimore. Ajo paraqet jo vetëm një arritje inxhinierike, por edhe një simbol të lidhjes ndërmjet qytetit dhe natyrës së ashpër të Rugovës.

Përveç saj, Peja ka pasur edhe ura të tjera historike, si Ura e Gurit (Ura N'Gur), që sot ruhen vetëm në kujtesën e banorëve dhe në bazamentet e mbeturat.

Në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të MKRS-së janë dy ura në Komunën e Pejës që gjeljnë mbrojtje ligjore.

Ura e Gurit (Ura Ngur) që në këtë listë figuron nga shekulli XVI dhe Ura në Grykën e Rugovës nga shekujt XVI- XX.

Urat më të njohura dhe të rëndësishme të Pejës janë:

- * Ura harkore e Gurit në Grykën e Rugovës
- * Ura e Gurit (Ura N'Gur)
- * Ura e Kilometrit të 10-të
- * Ura e Rexhep Agës
- * Ura e Zallit
- * Ura e Gegajve
- * Ura e Miletbahçes
- * Ura e vjetër pranë Patrikanës së Pejës
- * Ura e vjetër te Sharra
- * Ura tibetiane në Grykën e Rugovës

URA E GURIT (URA N'GUR)

E ndërtuar në shekullin XVI mbi lumin Lumbardh, Ura N'Gur është ndër urat më të vjetra të evidentuara në qytetin e Pejës dhe një nga objektet më të hershme të inxhinierisë në rajonin e Dukagjinit. Në një periudhë kur urat prej druri ishin të zakonshme, kjo urë prej guri përfaqëson një zgjidhje të qëndrueshme dhe funksionale për kalimin mbi lumë.

Sipas Xhevdet Belegut, i intervistuar për këtë hulumtim, ura ndodhej pranë sheshit "Haxhi Zeka" dhe shërbente si urë lidhëse në rrugën Pejë - Deçan - Gjakovë, duke e bërë një nyje të rëndësishme për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave, madje edhe më gjërë në drejtim të Malit të Zi. Afër urës ndodhej edhe një han i vjetër, i përdorur si bujtinë për udhëtarët, çka e bënte këtë vendkalim pjesë të rëndësishme të jetës tregtare dhe shoqërore të qytetit.

Nga burimet e shkruara dhe analiza e vendndodhjes, supozohet se ura ishte ndërtuar me tri harqe dhe dy dy dritare shkarkuese. Harku qendror, gjysmë-rrethor, mbulonte pjesën më të gjerë të lumit, ndërsa dy harqet anësore ishin më të vegjël dhe të vendosur në të dy skajet e saj. Forma me kurriz të lartë në qendër pasqyronte tiparet klasike të urave osmane, ndërsa kalldrëmi i pjerrët mbi harqet bregore lehtësonte qarkullimin edhe në kushtet të vështira të terrenit.



Burimet:

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Pejë

Intervista: Xhevdet Belegu, banor i vjetër i Pejës & Lira Avdiu, arkitektë(vizita ne terren: 10.07.2025)




Sipas rrëfimit të arkitektes Lira Avdiu, banore pranë urës, gjatë vërvshimeve, në lumë uji kishte ardhur me forcë të madhe dhe kishte marrë me vete edhe një pjesëtare të familjes së saj, e cila përfat të mirë kishte shpëtuar. Kjo dëshmi tregon jo vetëm për rrezikun e natyrës, por edhe për lidhjen emocionale dhe historike që banorët e zonës kanë me këtë urë.

Pas shkatërrimit të pjesës së sipërme, mbi bazamentet e saj u ndërtua një kalim i përkohshëm prej druri, i cili më vonë u zëvendësua me një urë metalike që përdoret edhe sot. Rrëfimet lokale sugjerojnë se emri "Ura N'Gur" mund të ketë origjinën nga fakti që vetëm themellet e saj ishin prej guri, ndërsa struktura e sipërme ishte prej druri.

Sot, nga kjo urë kanë mbetur vetëm bazamentet, të dëmtuara dhe në gjendje të rëndë. Megjithatë ato vazhdojnë të ruhen si dëshmi e vetme e këtij tipi ndërtimi në Pejë. Ura konsiderohet si një simbol i trashëgimisë urbane dhe mbetet një pikë referimi e rëndësishme për kujtesën historike të qytetit, që meriton vëmendje, restaurim dhe mbrojtje.

URA HARKORE E GURIT NË GRYKËN E RUGOVËS



Ura harkore e Gurit në Grykën e Rugovës në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkoħshme tē MKRS-sé figuron se daton nga shekujt XVI – XX. Ndodhet në kilometrin e pestë tē rrugës Pejë-Rugovë.

Kjo urë harkore paraqitet edhe si simbol nē stemën e Komunës së Pejës dhe përdoret si një nga pikat e identitetit tē Pejës.

Bazuar nē tē dhënat historike, rruga Pejë-Rugovë kalonte më parë përmes një ure tē vjetër, që besohet se ka ekzistuar deri në vitet 1920. Ajo ishte një urë me një hark tē madh gjysmërrethor, tē ndërtuar me gurë tē latuar dhe vendosur nē një zonë me disnivell tē theksuar, duke krijuar një siluetë arkitektonike mbresëlénës.

Ndërsa gjatë shekullit XX, u ndërtua ura aktuale, një urë harkore me një hark qendor dhe gjashtë dritare shkarkuese, tre nē secilën anë.

Kjo urë karakterizohet nga një konstruksion me gurë tē punuar mjeshtërisht, me veçori tē theksuar arkitektonike dhe brez gurësh dekorativë që e zbukurojnë pjesën e epërme. Ura përmban edhe një rrethojë metalike mbi murin anësor, ndërsa daljet dekoruese tē gurëve përgjatë gjatësisë së saj i shtojnë elegancën formës së ndërtimit.

Sipas Xhevdet Belegut, kjo urë ka pasur rëndësi strategjike pér gjithë krahinën. "Kjo rrugë ka qenë e vetmja që e ka bashku Kosovën me Malin e Zi. Këtu kanë kaluar njerëz, mallra, e gjithçka që vinte prej Rugove, Çakorit e më tej," tregon ai. Belegu thekson gjithashtu se Ura nē Grykën e Rugovës nuk ka qenë vetëm një kalim, por një dëshmi e aftësive tē ndërtuesve vendas, tē cilët kanë ditur tē përballen me sfidat e terrenit dhe tē ndërtojnë ura tē qëndrueshme dhe tē hijshme njëkohësisht.

Përmasat e saj, 5.3 metra e gjerë dhe 23.5 metra e gjatë, e bëjnë këtë urë funksionale edhe sot. Ajo ruan pjesë nga bazamenti origjinal, ndonëse me disa ndérhyrje tē mëvonshme tē realizuara nē fund tē shekullit XX.

Ura e 5 kilometrave vlerësohet si një aset i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore dhe inxhinierike tē Pejës. Ajo është jo vetëm dëshmi e historisë së ndërtimit nē këtë zonë, por edhe një simbol i qëndrueshmërisë dhe lidhjes ndërmjet qytetit dhe natyrës së egër tē Rugovës. Sot, përvëç funksionit tē saj, ura mbetet një atraksion i njobur turistik, shpesh e përmendur si një "margaritar i turizmit pejan".



Burimet:

Qendra Rajonale pér Trashëgimi Kulturore – Pejë
Gryka e Rugovës – Peja Tourism: <https://pejatourism.org/rugova-gorge/>
Intervista me Xhevdet Belegu (vizita ne terren: 10.07.2025)



URA E KILOMETRIT TË 10-TË



Në vazhdimësi të rrugës Pejë–Rugovë, rreth 5 kilometra më tej nga Ura e Gurit në Grykë, ndodhet Ura e Kilometrit të 10-të, një strukturë që gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të banorëve të kësaj ane. Edhe pse më pak e njojur në narrativën publike, kjo urë është pjesë e atij zinxhiri të rëndësishëm të kalimeve që i kanë shërbyer lëvizjes së njerëzve, mallrave dhe lidhjes së Pejës me zonat malore dhe më tej drejt kufirit me Malin e Zi.

Rëndësia e saj historike përmendet shpesh nga banorët e Rugovës, të cilët e kanë shfrytëzuar këtë urë për dekada. E ndërtuar fillimisht në periudha më të hershme, ura është rindërtuar në vitet 1970, duke u përforcuar dhe përshtatur për nevojat e kohës. Megjithatë, ajo ruan në vjetvete një simbolikë të veçantë për ata që e kujtojnë si pjesë të rrugëtit të përditshëm ndërmjet fshatrave të Rugovës dhe qytetit të Pejës.

Burimet:
Interview with Xhevdet Belegu (visit to site: 10.07.2025)




URA E REXHEP AGËS

Ura e Rexhep Agës ndodhet në të njëtin aks rrugor që ndjek drejtimin Pejë - Rugovë - Çakorr, një rrugë me rëndësi historike që ka lidhur Kosovën me Malin e Zi përmes Grykës së Rugovës. E ndërtuar në vitet '70 me beton-armaturë, kjo urë ishte pjesë e një serie urash funksionale që siguronin qarkullim të pandërprerë në një prej korridoreve më të rëndësishme malore të rajonit.

Sipas rrëfimit lokal, ura mban emrin e "Rexhep Agës", një banor me ndikim në këtë anë. Thuhet se Rexhep Aga e ndërtoi urën jo vetëm për përdorim vetjak, por edhe për udhëtarët dhe tregtarët që kalonin nëpër këtë rrugë strategjike.

Ashtu si Ura në Grykën e Rugovës, edhe kjo urë ka pasur një funksion të rëndësishëm për kalimin e njerëzve dhe mallrave ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, në një periudhë kur ishte ndër të paktat korridore rrugore funksionale. Edhe pse emri i saj nuk është aq i njohur në publik, banorët e zonës vazhdojnë ta njohin si një nga urat që dikur kishin rol të pazëvendësueshëm në infrastrukturën ndërkufitare të rajonit.



URA E ZALLIT



Ura e Zallit, e njohur ndryshe edhe si Ura e Rërës, ndodhet mbi lumin Lumbardh, në një pikë kyçë të qytetit të Pejës. Për dekada ka shërbyer si një ndër lidhjet më të rëndësishme urbane. E pozicionuar në zemër të qytetit, kjo urë ka ndihmuar në qarkullimin e përditshëm të njerëzve dhe mallrave, duke mbetur një pikë referimi për gjenerata të tëra. Ne fillim Qarshia e Pejes shtrihej nga Ura e Zallit gjeri te Ura e Gurit siq u quante Qarshia e Madhe. Ne vitin 1835, Qarshia e Pejes kishte 550 dyqane.

Sipas rrëfimit të Xhevdet Belegut, emri i urës lidhet me funksionin historik të saj: përreth saj është nxjerrë zalli me kuaj, i cili është përdorur për ndërtimin e shumë objekteve në qytet. Kjo e ka kthyer zonën në një qendër pune dhe tregtie të vogël, ku banorët merreshin me tregtinë e zhavorrit, duke i dhënë kësaj ure një rëndësi të veçantë ekonomike.

**Përveç rëndësisë së saj ekonomike dhe funksionale, Ura e Zallit ka luajtur rol edhe në zhvillimin kulturor të qytetit. Skender Pepa, anëtar i një familjeje të njohur për traditën e fotografisë në Pejë, rrëfen se pikërisht pranë kësaj ure janë realizuar fotografitë e para në qytet. **

Në rrëfimet e vjetra, kjo urë njihet gjithashtu edhe me emrin Ura e Istref Begollit, por ky emërtim është më pak i përdorur ndër qytetarët, ndërkohë që emri "Ura e Zallit" ka mbetur më i rrënjosur në kujtesën kolektive të banorëve.



Me gjithë transformimet e saj në dekada, ura vazhdon të mbajë një rol të rëndësishëm në jetën urbane të Pejës dhe mbetet një simbol i historisë së saj funksionale dhe ekonomike.

Burimet:

Trashegimia kulturore para shekullit XVIII e Pejës - Indira A. Hoxha (Gazeta Projekti):
<https://gazetaprojekti.com/shkruan-indira-a-hoxha-trashegimia-kulturore-para-shekullit-xviii-e-pejes/>

Këshfu dukej Ura e Zallit para 45 viteve - Facebook(Ku me shku në Pejë? :

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=4048760801853557&set=a.924955250900810>

Historia se si nisi fotografia në qytetin e Pejës! - RTV Dukagjini:

<https://www.facebook.com/RTVDukagjin/VIDEO/videos/1019872468972662>

Intervista me Xhevdet Belegu (vizita ne terren: 10.07.2025)

URA E GEGAJVE

Ura e Gegajve, e njohur nga qytetarët edhe si Ura e Gegicëve, është një prej urave karakteristike të Pejës që ka shërbyer për dekada si pikë kyçe lidhëse për komunitetin lokal. Edhe pse viti i ndërtimit të saj nuk është i saktësuar, mendohet se ajo daton nga periudha osmane. Fillimisht ishte një urë e ndërtuar nga druri, por pas vërvimeve të mëvonshme ajo u zëvendësua me një strukturë më të qëndrueshme metalike, duke ruajtur funksionalitetin e saj për komunitetin.


Ura ka pasur një rëndësi të veçantë në jetën e përditshme të banorëve të Pejës, veçanërisht për nxënësit e Gjimnazit dhe banorët e pjesës jugore të qytetit. Mahallat si Kapeshnica, Zatra dhe Karagaqi e kanë shfrytëzuar këtë urë si kalim të domosdoshëm për të arritur në qendrën e qytetit apo në institucionet arsimore.

Përveç funksionit primar, ura ka pasur edhe një rol në jetën shpirtërore të qytetit. Ajo ndodhet përbullë Xhamisë së Sahat Kullës, dhe ka shërbyer si urë kalimi për besimtarët që lëviznin për të kryer ritet fetare, duke e kthyer urën në një element të pandashëm të rrjedhës urbane dhe kulturore të qytetit.

Sot, Ura e Gegajve vazhdon të mbeten një simbol lokal, jo vetëm për funksionin e saj fizik, por edhe për rolin që ka luajtur në kujtesën kolektive të banorëve të Pejës.



Burimet:
Interview me Xhevdet Belegu (vizita ne terren: 10.07.2025)



URA E MILETBACHES

Ura e Miletbahces mban një emër me origjinë nga turqishtja që mund të përkthehet si "parku i popullit" dhe për një kohë të gjatë ka qenë më shumë sesa një urë kalimi.


Ajo ishte ngushtësish e lidhur me jetën shoqërore dhe politike të qytetit. Në afërsi të saj ndodhej një park që shërbente si vendtakim i përditshëm i qytetarëve dhe si hapësirë ku mbaheshin mbledhje dhe kuvende publike. Ky park kishte funksionin e një hapësire publike ku populli mblidhej për të ndarë mendime e vendime, duke e bërë këtë zonë një pikë nevralgjike të jetës urbane të Pejës.



Sipas rrëfimit të Xhevdet Belegut, aty pranë ishte i vendosur ish-komiteti dhe shtëpia e armatës, në zonën ku sot ndodhet ndërtesa e Komunës së Pejës, çka e bënte këtë urë pjesë të një nyje të rëndësishme të infrastrukturës institucionale dhe shoqërore të qytetit. Pas vitit 1979, ura është zhvendosur nga pozicioni i saj i mëparshëm dhe është rindërtuar pak më në jug. Megjithatë, roli i saj funksional është ruajtur dhe forcuar dhe sot, ajo lidh qendrën historike të qytetit me anën ku ndodhen institucionet komunale, duke qenë një ndër urat më të frekuentuara në jetën e përditshme të qytetarëve.

Ura e Miletbahces nuk është thjesht një element infrastrukturre, por për shumë qytetarë ajo përfaqëson një vend të kujtesës kolektive, ku rrjedh historia urbane dhe komunitare e Pejës.

Burimet:
Intervista me Xhevdet Belegu (vizita ne terren: 10.07.2025)



URAT E HUMBURA TË PEJËS

URA E VJETËR PRANË PATRIKANËS SË PEJËS

Një nga urat më të rëndësishme, por tashmë të zhdukura, është ajo që gjendej pranë Patrikanës së Pejës. Kjo urë ka shërbyer për të lidhur Kapeshnicën me pjesën e Rugovës dhe konsiderohet si një urë me funksion strategjik për banorët e zonës.

Që nga rrënimimi i saj, ura nuk është zëvendësuar dhe mungesa e saj mbetet një boshllék në lidhjen historike dhe funksionale të kësaj zone.

Burimet:

Interview with Xhevdet Belegu (visit to site: 10.07.2025)

URA E VJETËR TE SHARRA

Një tjetër urë e humbur është ajo që ndodhej pranë një punëtorie përpunimi të drurit, e njojur në qytet si "Sharra". Kjo urë datonte që nga vitet 1930 dhe ka pasur një funksion të rëndësishëm, duke lidhur qytetin me zonat përreth përmes një ure prej druri të ndërtuar nga mjeshtrit vendas. Afër kësaj ure gjendej punëtoria ku përpunoheshin drurët, veçanërisht nga kodra e Gështenjave në pjesën perëndimore të qytetit.

Druri i gështenjës ishte shumë i preferuar për ndërtimin e urave, për shkak të qëndrueshmërisë së tij ndaj lagështisë, dhe përbënte materialin bazë për pjesën më të madhe të urave të vjetra të Pejës. Punëtorët e kësaj sharre përgatitnin trarët dhe elementet mbajtëse që përdorej për ndërtimin e urave në qytet. Edhe pse ura e vjetër nuk ekziston më, në afërsi të saj është ndërtuar një urë e re, por historia e saj mbetet pjesë e memories kolektive të qytetit.

Burimet:

Interview with Xhevdet Belegu (visit to site: 10.07.2025)

URAT TURISTIKE NË GJAKOVË DHE PEJË

URA TIBETIANE NË GRYKËN E RUGOVËS

Në zemër të kanionit të thellë të Rugovës, pranë qytetit të Pejës, është ndërtuar një urë e pazakontë që po kthehet në një nga atraksionet më të veçanta për vizitorët e apasionuar pas aventurës dhe natyrës. Kjo është ura tibetiane, një strukturë prej 40 metrash e gjatë, mbi rrjedhën e egër të lumit që përshkon grykën. Ajo ndodhet në hyrje të një prej via ferratave më të njohura në Kosovë, "Marimangat", duke i ofruar vizitorëve një hyrje spektakolare në një itinerar alpin me peizazhe mahnitëse.




Përveç funksionit të saj sportiv, ura tibetiane në Grykën e Rugovës shërben edhe si pikë ndalese për fotografi, pushim dhe reflektim, duke e bërë atë të preferuar nga turistët vendas e të huaj. Prezenca e saj përforcon edhe më shumë pozicionin e Rugovës si një destinacion i rëndësishëm për turizmin aventurier dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor në Kosovë.

E ndërtuar për të rritur qasjen në sporte malore dhe për të ofruar përjetime unike vizuale, kjo urë nuk ka funksion tradicional të kalimit urban apo lidhjes së lagjeve, por është menduar enkas si një pikë atraktive për adrenaline dhe turizëm malor. Ecja mbi të nuk është vetëm një kalim i thjeshtë, është një përjetim, ku çdo hap mbi dërrasa shoqërohet nga ndjesia e lartësisë dhe panorama e thepisur e maleve përreth.

Burimet:

Gryka e Rugovës bëhet me urën më të veçantë në Ballkan - Albinfo.ch:
<https://www.albinfo.ch/gryka-e-rugoves-behet-me-uren-me-te-vecante-ne-ballken/>
Ura më e gjatë tibetiane në Ballkan ndodhet në Gryken e Rugovës - Koha.mk:
<https://koha.mk/fr/ura-me-e-gjate-tibetiane-ne-ballkan-e-gjeni-ne-gryken-e-rugoves/>

URA TIBETIANE NË GJAKOVË



Në afërsi të urës së vjetër të Fshajt, një strukturë e re ka shtuar dimension të ri përvojës turistike në këtë pjesë të lumit Drini i Bardhë, ura tibetiane, më e gjata e këtij lloji në Ballkan. Kjo urë nuk është thjesht një shteg mbi kanionin e thllë, por një përjetim që sfidon ndjenjat, zgjon kureshtjen dhe lidh njerëzit me natyrën në mënyrë të pazakontë. Kalimi mbi të nuk ofron vetëm pamje mbresëlënëse të rrjedhës së bardhë të lumit dhe shkëmbinje që ngrihen në të dy anët e kanionit, por krijon një ndjesi bashkëjetese me hapësirën. Këtu, vizitorët përballen me lartësinë, me emocionin, me frikën, por edhe me guximin dhe kjo e bën urën një pikë takimi jo vetëm të trupit me natyrën, por edhe të shpirtit me përvojën.

Ura tibetiane në Gjakovë ka sjellë një gjallëri të re në jetën kulturore e sociale të zonës. Ajo ka tërhequr vizitorë nga vende të ndryshme, duke ofruar një arsyё më shumë për të ndaluar, për të eksploruar dhe për të njojur më mirë këtë pjesë të pasur të Kosovës. Rrjedhimisht, ka nxitur edhe zhvillimin ekonomik lokal përmes turizmit, duke ndihmuar që fshati Fshajt dhe rrethina e Gjakovës të bëhen më të njoitura dhe më të frekuentuara.


Burimet:

Përurohet ura tibetiane në Gjakovë, më e gjata e këtij lloji në Ballkan - Syri vision:

<https://www.syri-vision.tv/perurohet-ura-tibetiane-ne-gjakove-me-e-gjata-e-ketij-lloji-ne-ballkan/>

European Union in Kosovo (Facebook post)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=4594980230521197&set=pcb.4594981293854424>



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

PËRFUNDIME

Ky hulumtim ka nxjerrë në pah rëndësinë shumëdimensionale të urave në qytetet e Gjakovës dhe Pejës jo vetëm si struktura inxhinierike, por si pjesë të pandashme të identitetit urban, kujtesës kolektive dhe zhvillimit kulturor të këtyre qyteteve.

Në Gjakovë, urat si Ura e Terzive, Ura e Tabakëve, Ura e Taliqit apo Ura e Fshejtë jo vetëm që janë të ruajtura fizikisht, por ato vazhdojnë të qëndrojnë në vendndodhjet e tyre origjinale, duke ruajtur strukturën arkitekturore autentike, ndërtimin prej guri dhe elementet estetike që i karakterizonin që nga shekujt XVIII e XIX. Këto ura janë dëshmi të gjalla të mjeshtërisë tradicionale dhe bartin një vlerë të jashtëzakonshme në trashëgiminë kulturore materiale të vendit.


Ndërsa urat e Pejës, ndonëse të shumta në numër dhe të shpërndara në gjithë territorin urban dhe përreth, në pjesën dérrmuese nuk janë të ruajtura në formën e tyre origjinale. Gati të gjitha janë rindërtuar pas shekullit XX, shumica në vitet 1970 e tutje, shpesh me konstruksione të beton-armaturës, siç është rasti me Ura e Zallit, Ura e Rexhep Agës, apo ura në kilometrin e dhjetë në drejtim të Rugovës. Megjithatë, ajo që i jep rëndësi

këtyre urave nuk është forma e tyre aktuale, por historia, kujtesa dhe funksioni që kanë bartur në të kaluarën. Banorët i lidhin ende me ngjarje, lagje, vendkalime dhe rite të përditishme që kanë formuar jetën e qytetit në dekada më parë.

Në Gjakovë, ka ndodhur një ruajtje fizike dhe estetike e vetë objekteve, ndërsa në Pejë, trashëgimia është mbajtur gjallë përmes rrëfimeve, emërtimeve dhe kujtimeve të banorëve, edhe pse urat origjinale janë zhdukur ose zëvendësuar.

Në të dy rastet, hulumtimi dëshmon se urat janë më shumë sesa struktura funksionale, ato janë nyje të kujtesës urbane, dëshmi të zhvillimeve historike dhe rrugëkalime të jetës sociale, ekonomike dhe shpirtërore të qyteteve. Rëndësia e tyre është e dyfishtë: fizike dhe simbolike.

Në fund, mbetet e qartë se pavarësisht rrënimit fizik të disa urave apo ndërrimit të funksioneve, ndjeshmëria dhe lidhja e komunitetit me këto ura vazhdon të jetë e fortë. Kjo është një bazë e mirë për të nxit ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e tyre si pjesë integrale e trashëgimisë kulturore të rajonit.



REKOMANDIME


Për këto arsyе, EC Ma Ndryshe rekomandon:

- * Dokumentimin dhe dixhitalizimin e urave ekzistuese dhe të humbura, respektivisht të përpilohet një arkiv gjithëpërfshirek që përfshin të dhëna teknike, historike dhe rrëfime lokale për secilën urë, me qëllim ruajtjen e kujtesës kolektive dhe promovimin kulturor.
- * Restaurimi dhe mbrojtja e urave me vlera historike: Të ndërmerren masa emergjente për restaurimin e urave të dëmtuara si Ura N'Gur në Pejë dhe të tjera që ruajnë pjesë të strukturës origjinale, duke u bazuar në parime të konservimit dhe përdorimit të teknikave autentike.
- * Integrimi i urave në politikat e zhvillimit urban dhe turizmit kulturor: Urat të trajtohen jo vetëm si infrastrukturë, por si pika të rëndësishme për planifikim urban, identitet lokal dhe atraksione për vizitorë.
- * Përdorimi i turizmit kulturor si mjet zhvillimi: Urat të përfshihen në itinerare turistike kombëtare dhe ndërkombëtare. Përvoja të integrarë turistike, që lidhin historinë, natyrën dhe aktivitetet sportive (si kërcimet nga Ura e Fshajtë), mund të sjellin përfitime ekonomike për komunitetet lokale.
- * Përfshirja e komunitetit në proceset e ruajtjes: Të nxitet dokumentimi i kujtimeve, rrëfimeve dhe përdorimeve tradicionale përmes intervistave me qytetarët, për të ruajtur lidhjen emocionale dhe funksionale me këto struktura.
- * Vodosja e sinjalistikës dhe tabelave informuese: Të vendosen tabela pëershkruese për secilën urë që përbajnjë informata historike dhe kulturore, në mënyrë që qytetarët dhe vizitorët të kuptojnë rëndësinë e tyre.
- * Zhvillimi i programeve edukative dhe ndërgjegjësuese: Të përfshihen temat e trashëgimisë së urave në kurrikulat shkollore dhe të organizohen vizita, aktivitete artistike dhe kulturore rrëth tyre, për të ndërtuar ndjenjën e përkatesisë dhe mbrojtjes.
- * Hartimi i strategjisë së përbashkët për ruajtjen e urave historike në nivel komunal dhe rajonal, duke bashkërenduar veprimet ndërmjet institucioneve të trashëgimisë, komunave, organizatave lokale dhe komuniteteve të interesuara.

FOTO TË VJETRA TË URAVE NË GJAKOVË DHE PEJË



Ura e Zallit (Pejë)



Ura e Fshajtë (Pejë)



Ura e Tabakëve (Gjakovë)



Ura e Tabakëve (Gjakovë)



Ura e Tabakëve (Gjakovë)



Mbishkrimi i urës së Tabakëve



Ura e Taliqit (Gjakovë)



Ura e Taliqit (Gjakovë)




Ura e Islam Begut (Gjakovë)



Ura e Islam Begut (Gjakovë)



Ura e Terzive (Gjakovë)



Ura e Fshajtë (Gjakovë)



Ura e Gurit (Pejë)




Ura e Zallit (Pejë)

Gjakova djep i kultures dhe tradites shqiptare.

Femra e pare ne Balkan

Gonxhe Xhiha 1983




URA E TALIOIT



Ura e Talioit



Ura e Miletbahces




Gjakova djep i kultures dhe trautes shqiptare.

Ali podrimja-Ali Taljoni



Ura e Tabakëve (Gjakovë)




Ura e Fshajtë (Gjakovë)

Gara e kërcimeve nga ura e Fshajtë
(Gjakovë)


TABELA E KOORDINATAVE TË URAVE

NR	Emri	Qyteti	Kordinatat
1.	Ura e Terzive	Gjakovë	42.358765, 20.510213
2.	Ura e Tabakëve	Gjakovë	42.370698, 20.421444
3.	Ura e Fshajtë	Gjakovë	42.352802, 20.541270
4.	Ura Romake	Gjakovë	42.317664, 20.591240
5.	Ura e Taliqit	Gjakovë	42.375839, 20.428214
6.	Ura e Islam Belegut	Gjakovë	42.383741, 20.427967
7.	Ura tibetiane në Fshajt	Gjakovë	42.353021, 20.540145
8.	Ura e Gurit	Pejë	42.658255, 20.292364
9.	Ura e Gegajve	Pejë	42.659376, 20.279471
10.	Ura e 10 Kilometrit	Pejë	42.664294, 20.205323
11.	Ura e Rexhep Agës	Pejë	42.661386, 20.242768
12.	Ura e Gurit me Hark në Grykën e Rugovës	Pejë	42.664497, 20.231063
13.	Ura e Zallit	Pejë	42.658755, 20.286026
14.	Ura e Milet bahçes	Pejë	42.658691, 20.288600
15.	Ura Tibetiane	Pejë	42.662310, 20.240061

VENDNDODHJA E URAVE TË RAJONIT TË GJAKOVËS



VENDNDODHJA E URAVE TË RAJONIT TË PEJËS



BURIMET:

Bridges of Dublin – Anji Bridge (605AD) Linku:

<http://www.bridgesofdublin.ie/bridge-building/famous-bridges/anji-bridge-605ad>

Wikepdia – Linku: https://en.wikipedia.org/wiki/Anji_Bridge#cite_note-Roman_bridges-1

<https://www.nyc.gov/html/dot/html/infrastructure/brooklyn-bridge.shtml>

Ura e Terzive - Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:

<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=2861>

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjakovë

Ura e Terzive - Atlas Obscura: <https://www.atlasobscura.com/places/ura-e-terzive>

Ura e Terzive në Gjakovë, një arritje e jashtëzakonshme arkitektonike – Telegrafi:

<https://telegrafi.com/ura-e-terzive-ne-gjakove-nje-arritje-e-jashtezakonshme-arkitektonik-e/> Mbyllt faza emergjente në urën më emblematike të Gjakovës - CHWB Kosova:

https://chwbkosova.org/sq/chwb_news/mbyllt-faza-emergjente-ne-uren-me-emblematike-te-gjakoves-2/

Ura e Tabakëve - Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:

<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=2810>

Përurohet Ura e restauruar e Tabakëve në Gjakovë – Koha:

<https://www.koha.net/kulture/perurohet-ura-e-restauruar-e-tabakeve-ne-gjakove>

Ura e Tabakëve, Gjakovë - Facebook Monuments of Albania:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=2750131531894586&id=1531035643804187&set=a.1531541350420283>

Lista e monumenteve në mbrojtë të përkohshme e Ministrisë Kulturës Rinisë dhe Sportit:

https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5360_2_2.pdf

Skënderbeu në gur – Prizrenpress: <https://prizrenpress.com/skenderbeu-ne-gur/>

Ura e Fshajt - legjenda për urën e besës dhe fjalës së dhënë – Epoka e re:

<https://www.epokaere.com/ura-e-fshajt-legjenda-per-uren-e-beses-dhe-fjales-se-dhene/>

Ura e fshejtë, një histori e veçantë – Rexhep Kelmendi për ATV – 07.18.2023:

<https://www.youtube.com/watch?v=i9tRQJWUYD0>

Ura romake e shekullit I, në Rogovë të Hasit - Klan Kosova interviste me Osman Gojani:

<https://klankosova.tv/ura-romake-e-shekullit-i-ne-rogoje-te-hasit-video/>

Ura e Taliqit - Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës:

<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=2858>

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjakovë

Ura e Taliqit ndervite - Gjakova Sot:

<https://www.facebook.com/Gjksot/posts/ura-e-taliqit-ndervitegjakove/2049171681880155/>

Taliq Bridge- Explore Gjakova: <https://www.explorejkakova.com/listing/taliqbridge/>

Gryka e Rugovës – Peja Tourism: <https://pejatourism.org/rugova-gorge/>

Trashëgimia kulturore para shekullit XVIII e Pejës - Indira A. Hoxha (Gazeta Projekti):

<https://gazetaprojekti.com/shkruan-indira-a-hoxha-trashegimia-kulturore-para-shekullit-xviii-e-pejes/>

Kështu dukej Ura e Zallit para 45 viteve - Facebook(Ku me shku n'Pejë?:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=4048760801853557&set=a.924955250900810>

Historia se si nisi fotografia në qytetin e Pejës! – RTV Dukagjini:

<https://www.facebook.com/RTVDukagjiniVIDEO/videos/1019872468972662>

Gryka e Rugovës bëhet me urën më të veçantë në Ballkan - Albinfo.ch:

<https://www.albinfo.ch/gryka-e-rugoves-behet-me-uren-me-te-vecante-ne-ballkan/>

Ura më e gjatë tibetiane në Ballkan ndodhet në Grykën e Rugovës - Koha.mk:

<https://koha.mk/fr/ura-me-e-gjate-tibetiane-ne-ballkan-e-gjeni-ne-gryken-e-rugoves/>

Përurohet ura tibetiane në Gjakovë, më e gjata e këtij lloji në Ballkan - Syri vision:

<https://www.syri-vision.tv/perurohet-ura-tibetiane-ne-gjakove-me-e-gjata-e-ketij-lloji-ne-ballkan/>

Eurpoean Union in Kosovo (Facebook post)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=4594980230521197&set=pcb.4594981293854424>

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Pejë

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjakovë

Intervista :

Xhevdet Belegu banor i vjetër i Pejës;

Lira Avdiu, arkitekte

Librat dhe titujt:

HARTA ARKEOLOGJIKE E KOSOVËS – AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË 2006

Artan Krasniqi – Monument Vellimi III – Shekujt e mesëm (Prishtinë Mitrovicë, Pejë dje

Gjakovë)

PËR EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe

përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institacioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgata.

Deklarata e vizonit

"Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme".

Deklarata e misionit

"EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike".

EC
MA NDRYSHE

www.ecmandryshe.org